

VENDIM
Nr. 122, datë 17.2.2016

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT TË
MENAXHIMIT, TË KALKULIMIT DHE PAGESËS SË PËRFITIMIT (PCAMS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit, të kalkulimit dhe pagesës së përfitimeve, të quajtur PCAMS.

2. PCAMS-ja administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Përbërësit e arkitekturës, *software* dhe *hardware* të sistemit, miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

4. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen ato të dhëna të cilat grumbullohen nga vetë kjo bazë të dhënash dhe përfshijnë:

- periudhën kontributive;
- dokumentet e nevojshme të skanuara;
- kërkesat për caktim pensioni (numrin dhe datën);
- kërkesat për rishqyrtim pensioni (numrin, datën dhe arsyen);
- kërkesat për transferim pensioni (numrin, datën);
- llojin e pensionit;
- masën e pensionit;
- datën e fillimit të pensionit;
- pikën paguese të pensionit.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga baza të tjera të dhënash dhe përfshijnë të dhënat referencare nga regjistri i Gjendjes Civile, si: numrin e identifikimit, emrin, mbiemrin, atësinë, emrin e nënës, vendlindjen, datëlindjen, mbiemrin e vajzërisë, ZGJC_CODE.

5. Subjektet përgjegjëse të PCAMS-së janë si më poshtë vijon:

- a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- b) Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore përkatëse;
- c) Degët e sigurimeve shoqërore;
- ç) Agjencia Rajonale e Sigurimeve Shoqërore përkatëse.

6. Dhënës të informacionit janë:

- a) Qytetarët të cilët plotësojnë kushtet për përfitim;
- b) Drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore;

7. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të PCAMS-së është, si më poshtë vijon:

a) Qytetarët kanë të drejtë të marrin informacion vetëm duke pasur një mjet identifikimi;

b) Shërbimi social ka vetëm të drejtë të lexojë dhe të marrë informacion për çdo individ që është në bazën e të dhënave;

c) Institucionet që kryejnë pagesat kanë vetëm të drejtë të lexojnë dhe të kryejnë pagesat;

ç) Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave dhe sistemin në rolet e:

- i) administratorit;

- ii) raportuesit;
- iii) audituesit;
- iv) zhvilluesit.

d) Subjektet e tjera, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave, mund të kenë akses në nivelin raportues apo statistikor për të monitoruar apo për të raportuar.

8. PCAMS-ja ndërvepron me bazën e të dhënave të RKGJC-së vetëm me të dhënat parësore.

Proceset e punës në bazën e të dhënave të PCAMS-së përcaktohen me rregullore të brendshme ose me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në përputhje me rregullat në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

9. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe strukturat në varësi të tij për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama